



PROJEKT- VENDIM

Nr. 114 Datë 19.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PER SHQYRTIMIN E KERKESES
PER MIRATIMIN E PLANIT TE INVESTIMEVE 2015 PER OSHEE
SH.A.**

Në mbështetje të neneve 9,24, dhe 64të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Licensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **19.11.2014**, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEEsh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga OSHEE sh.a ka mangësi dhe plotësime që duhet të bëhen në mënyrë që Grupit të Punës së ngritur me urdhërin e Kryetarit të ERE-s Nr.74 dt 10.10.2014, t’i mundësohet një gjykim i drejtë për propozimin e miratimit të planit të investimeve. Për këtë arsye OSHEE sh.a. –së i janë bërë me dije kërkesat e ERE-s për përmirësimin e dokumentacionit të aplikimit si mëposhtë :

- Ne zbatim te Nenit 7 paragrafi 3, kërkesa per miratim te planit te investimeve duhet te shoqerohet me nje raport te zbatimit te planit parardhes ku tregohet ecuria e investimeve te planifikuara dhe shpjegime rreth cdo ndryshimi.
- Viti 2014 eshte viti i fundit i periudhes se Trete Rregullatore, e per kete arsye eshte e nevojshme qe te paraqitet njera por ti detajuar lidhur me Planifikim/Realizimin per periudhen 2012-2014. Duhet te paraqiten investimet e planifikuara/realizuara te vitit dhe do te shoqerohen me nje shpjegues lidhur me investimet e parashikuara por qe nuk jane realizuar dhe shpjegime per investimet e paparashikuara ne planin e miratuar por te realizuara.

- Plani i Investimeve per vitin 2015 duhet te shoqerohet gjithashtu edhe me shpjegime e te dhena te mjaftueshme lidhur me investimet afat gjata qe planifikohen.
- Natyrisht kerkohet qe te dokumentohet miratimi i Planit te Investimeve 2015 nga Keshillat Mbikqyrese perkatese.

Përgjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të miratojë fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për mirratimin e planit të Investimeve 2015 për OSHEE sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 114 Datë 19.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KERKESËS
PËR MIRATIMIN E PLANIT TE INVESTIMEVE 2015 PËR OSHEE
SH.A.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____